




Albanian-American
Development Foundation



Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Fakulteti i Edukimit

Departamenti i Mësuesisë

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE

JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: Edukimi dhe Lidërshipi

“Sfidat e edukimit online në universitetet shqiptare/ perceptimet e studentëve në lidhje me mësimin në distancë.”

Autore: Lidia Reçi

Bachelor në Arsim Fillor

Lidia Reçi

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Sfidat e edukimit online në universitetet shqiptare/ perceptimet e studentëve në lidhje me mësimin në distancë

Abstrakt

Prej më shumë se një viti, si rezultat i pandemisë COVID-19, edukimi nëpërmjet internetit është kthyer në metodën kryesore të arsimit në mbarë botën. Edhe në Shqipëri, të mësuarit përmes platformave online është kthyer tashmë në një realitet të imponuar nga kriza. Në përballjen e parë me këtë format të ri të mësuari, studentët, pedagogët dhe të gjithë aktorët kryesorë të institucioneve të arsimit të lartë nuk e patën të lehtë të adaptohen, prandaj në shumë raste i gjithë procesi ka patur edhe problematika, që kanë ardhur si rezultat i mungesës së informacionit për përdorimin e platformave didaktike online, mungesës së mjeteve teknologjike, pamundësisë financiare të studentëve etj. Ky punim analizon pikërisht procesin e mësimin online si dhe perceptimin e studentëve shqiptarë lidhur me këtë formë edukimi në distancë në kontekstin e efektivitetit, avantazheve, disavantazheve, ndërveprimit shoqëror dhe hapësirave për përmirësim. Në punim janë përdorur metoda cilësore të hulumtimit. Krahas vjeljes së materialeve nga studime shkencore rreth mësimdhënies online, për mbledhjen e të dhënave janë përdorur edhe pyetësorë, me qëllim analizimin e perceptimeve të studentëve rreth mësimin online. Këta pyetësorë janë dërguar tek 100 studentë, në tre universitete në vend. Rezultatet e këtij punimi tregojnë se një numër i konsiderueshëm i studentëve shqiptarë nuk e preferojnë edukimin online, për shkak të numrit të madh të

vështirësive teknike që kanë hasur, kryesisht në vitin akademik 2020-2021, ndërsa një pjesë e vogël e tyre e konsiderojnë edukimin online si një nga mënyrat më efektive të arsimimit.

Fjalë kyç: *mësim online, avantazhe, mangësi, efektivitet, motivim*

Hyrje

Me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, udhëzimet mbi mësimin online janë shfaqur si një mënyrë alternative e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe si një plotësues i rëndësishëm i mësimdhënies tradicionale (Mary et al., 2006). Perceptimet e studentëve lidhur me edukimin online marrin rëndësinë e një çështje parësore por edhe shumë sensitive, si një çelës që hap rrugën për zhvillimin e mëtejshëm të arsimimit nëpërmjet internetit në shoqërinë shqiptare. Duke qenë vëzhgues të edukimit online përmes perspektivave të studentëve të ndryshëm mundëson afërsinë deri në një nivel të prekshëm të nevojave e më tej të aspiratave të tyre lidhur me këtë formë unike dhe inovative të arsimimit në Shqipëri.

Sfida e të mësuarit online nga ana e studentëve u kthye në një barrierë tepër të vështirë për t'u kapërcyer e kjo jo vetëm si rezultat i mungesës së interaktivitetit social ballë për ballë, por edhe si pasojë e vështirësive lidhur me infrastrukturën, mungesën e mjeteve të nevojshme ose për më tepër edhe mungesën e aksesit në internet për shumë vende të Shqipërisë të tilla si zona të vështira malore ose fshatra të thella me terren të vështirë. Megjithatë përpos vështirësive mësimi online ka qenë pranë studentëve atëherë kur mësimi fizik e kishte të pamundur, për ta zëvendësuar disi dhe për të mos lënë hapësira në formimin e tyre profesional ose shkencor gjatë arsimimit universitar.

Shumë studime kanë sjellë në vëmendje perceptimet e studentëve lidhur me këtë temë për të nxjerrë në pah efektivitetin por edhe hendeqet ku ka nevojë për përmirësim. Studimi i kryer nga Isman shpjegon se kalimi nga mësimi në mjedisin fizik në mjedisin online lidhet me cilësitë personale të tilla si motivimi, përqëndrimi, stilet e të mësuarit, gjinia, dhe përvojat e mëparshme të të mësuarit online, si faktorë që formojnë perceptimet e individëve, të cilat duhet të integrohen për t'u siguruar që programet e të mësuarit në internet janë të suksesshme (2010). Ndërsa Park në përfundimin e studimit të tij thekson se është e nevojshme të kryhen kërkime që merren më intensivisht me perceptimin e studentëve, qëndrimin dhe qëllimin e tyre për të përdorur të mësuarit elektronik lidhur me subjektivitetin e tyre për sa i përket dobive dhe efikasitetit, ose lidhur me faktorët organizativë siç janë aksesueshmëria e sistemit (2009). Ja përse ky punim ka në fokus pikërisht sjelljen në vëmendje të asaj që studentët mendojnë për arsimimin online në Shqipëri dhe të ideve të tyre lidhur me atë çka duhet bërë për të arritur në një shkallë më të lartë të përparimit në fushën e edukimit online në vendin tonë.

Rishikim i literaturës

Klasa e ashtuquajtur e përmbysur, ku studentët mësojnë nëpërmjet përmbajtjeve udhëzuese online kryesisht duke ndjekur mësimin nga platforma të ndryshme nëpërmjet internetit ose duke parë video në shtëpi ka marrë hov gjatë viteve të fundit. Sot shumë shkolla ofrojnë mësim virtual për shkak të COVID-19 e si rezultat studentët po përdorin video dhe materiale të tjera për të përmirësuar përvojat e tyre të të mësuarit, pavarësisht nëse universiteti i tyre ka përdorur modelin e klasës së përmbysur ose jo përpara pandemisë (Woytus, 2020).

Megjithëse të mësuarit nëpërmjet internetit vazhdon të rritet me shpejtësi në numër aplikimesh, ai mbetet ende në një fazë të hershme të zhvillimit të tij. Si pasojë, zhvilluesit dhe ofruesit e mësimit online kanë nevojë për të kuptuar më shumë se si studentët perceptojnë dhe reagojnë ndaj elementeve të këtij lloji të mësuarit, pasi perceptimi dhe qëndrimi i studentit është një element kritik për ta motivuar atë në procesin e të mësuarit e për të arritur kështu zbatimin e një qasje më efektive e të përmirësuar të të mësuarit në distancë nëpërmjet internetit (Bali and MC Liu, 2018).

Studiuesit kanë zbuluar se mësimi online ka efekt në arritjet e të nxënimit të studentëve dhe në motivimin e tyre gjatë procesit të të mësuarit. Ky rezultat mund të shpjegohet me faktin se zhvillimi i duhur mësimit në këtë formë do të ishte efektiv në shumë fusha mësimore, pasi përfshin zgjidhjen e problemeve të botës reale, hartimin e veprimtarive efektive të të mësuarit në klasë, ndërveprime efikase përmes teknologjive të informacionit dhe integrim të modeleve të tjera pedagogjike sipas karakteristikave të fushave të ndryshme të të mësuarit. Megjithatë ata theksojnë se zbatimi i mësimit online duhet të marrë në konsideratë përvojat e studentëve, njohuritë e mëparshme, aftësitë e teknologjisë së informacionit dhe aftësitë e komunikimit që ata zotërojnë, për të zhvilluar një proces efektiv të të nxënimit dhe mësimdhënies (Woytus, 2020).

Chun-Ming Hung (et al. 2021 cit. Barroës, 1996) tregon se nëpërmjet mësimit online studentët nxiten të kërkojnë metoda më efikase të të mësuarit bazuar në njohuritë dhe aftësitë e tyre themelore, dhe në njohuritë e të mësuarit nëpërmjet internetit, si një strategji e favorshme e mësimnxënies, që i drejton studentët në zbatimin e njohurive dhe drejt zgjidhjes së problemit. Gjithashtu ai shton (cit. Schmeck and Lockhart, 1983) se strategjitë e të nxënimit online si metoda të zbatuara në procesin e të mësuarit i ndihmojnë studentët në përvetësimin, menaxhimin dhe integrimin e njohurive, si dhe në zgjidhjen e

problemeve në mënyrë të pavarur. Përveç kësaj mësimi nëpërmjet internetit është një qasje e tillë që vë në punë në një shkallë të lartë te studentët proceset njohëse, për të arritur edhe sipas taksonomisë së Bloom-it objektivat arsimore, të tilla si "analizimi", "vlerësimi" dhe "krijimi" (cit. Anderson, Krathöohl, Airasian, Cruickshank, Mayer, Pintrich, et al., 2001; Bloom et al., 1956).

Një nga faktorët më të rëndësishëm i të mësuarit përmes internetit është prania sociale. Prania shoqërore mund të përcaktohet si shkalla e interaktivitetit midis dy komunikuesve të cilët përdorin një medium komunikimi që lidhet me të mësuarin nëpërmjet internetit. Duke komunikuar ndonëse online dhe jo ballë për ballë, individët kontribuojnë në formimin e një klime sociale në klasë. Nëse prania shoqërore është e ulët, kjo do të thotë se ndërveprimi në procesin e të mësuarit është gjithashtu i ulët. Bashkëveprimi shoqëror gjatë procesit të të mësuarit, i cili është shumë thelbësor për të mësuarit e suksesshëm, siguron dhe mbështet të mësuarit produktiv dhe kuptimplotë. Përveç kësaj, ndërveprimi shoqëror promovon angazhimin në mësimnxënie duke ndikuar në arritjen e rezultateve më të larta të të nxënës (Bali and MC Liu, 2018).

Sidoqoftë, mbetet një sfidë për të promovuar motivimin dhe përqendrimin e studentëve në detyrat e të nxënës e për më tepër, është gjithashtu e rëndësishme të sigurohet një mënyrë për të udhëzuar studentët në mënyrë që të organizojnë siç duhet njohuritë e tyre gjatë të mësuarit online. Prandaj, zhvillimi i një strategjie efektive udhëzuese mbi edukimin nëpërmjet internetit është bërë një çështje e rëndësishme dhe sfiduese kohët e fundit (Chun-Ming Hung et al. 2021).

Metodologjia

a) Konteksti dhe pjesëmarrësit

Pjesëmarrësit në këtë punë kërkimore (numri: 100 persona) janë studentë që ndjekin studimet në nivelin Bachelor në universitete shtetërore të Shqipërisë përkatësisht në universitetet e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit, të cilët studiojnë në programe studimi nga më të ndryshmet. Të dhënat demografike të studentëve pjesëmarrës lidhur me gjininë, vitet e studimit, vendbanimin dhe mundësitë ekonomike të tyre tregohen në tabelën A.

Tabela A. Të dhënat demografike të studentëve

GJINIA	Numri i studentëve	Numri i studentëve në përqindje
Meshkuj	40	40%
Femra	60	60%
VITET E STUDIMIT		
Viti i parë	27	27%
Viti i dytë	36	36%
Viti i tretë	37	37%

VENDBANIMI		
Fshat	58	58%
Qytet	42	42%
STUDENTË ME PAMUNDËSI EKONOMIKE	38	38%

b) Instrumenti

Për të mbledhur të dhëna lidhur me perceptimet e këtyre studentëve u përdor si instrument një pyetësor me 5 pyetje:

1. Sa efektiv ju duket mësimi online?
2. Cilat janë përparësitë e mësimit online?
3. Cilat janë mangësitë e mësimit online?
4. Çfarë mund të përmirësohet?
5. Sa i/e motivuar jeni për të marrë pjesë në mësimin online?

c) Analiza e të dhënave

Pas mbledhjes së të dhënave ato u organizuan në tabela dhe grafikë në programin kompjuterik Microsoft Exel, duke i ndarë në 4 grupe me nga 25 studentë secili e më pas duke i bashkuar të dhënat e grupeve për të arritur drejt rezultateve.

Kufizimet e punës kërkimore

Pyetësi u plotësua nga studentë që studiojnë në universitete shtetërore në nivelin Bachelor vetëm në tri vende të Shqipërisë përkatësisht në Tiranë, Durrës dhe Elbasan dhe gjithashtu numri më i lartë i studentëve pjesëmarrës i përket gjinisë femërore.

Rezultatet

Mbi dimensionet: efektivitet dhe motivim për pjesëmarrjen në mësimin online u përdor një shkallë me pesë pikë (secilit student pjesëmarrës ju kërkua të jepte vlerësimin përkatës me një numër nga 1-5). Rezultatet e marra janë treguar në tabelën **B**.

Tabela **B**. *Efektiviteti dhe Motivimi mbi mësimin online.*

Dimensioni	Shkalla nga 1-5	Numri i studentëve	Numri i studentëve në përqindje
Efektiviteti			
	1	34	34%
	2	33	33%
	3	20	20%
	4	13	13%
	5	0	-

Motivimi			
	1	42	42%
	2	30	30%
	3	18	18%
	4	10	10%
	5	0	-

67% e studentëve e vlerësuan efektivitetin e mësimit online në një shkallë të ulët, 20% në një shkallë mesatare dhe vetëm 13% në shkallë të lartë.

72% e studentëve kanë motivim të ulët mbi pjesëmarrjen në mësimin online, 18% motivim në një shkallë mesatare dhe vetëm 10% në një shkallë të lartë.

Perceptimet e studentëve lidhur me avantazhet e mësimit online:

Mundësi studimi nga shtëpia që ofron komfort dhe kursim në para, energji dhe kohë të cilat do t'i kushtoheshin transportit ose banesave me qira në zonat pranë universiteteve e si rezultat kjo i lehtëson pjesëmarrjen dhe i ofron një program ditor më fleksibël. Kjo lidhet sidomos me një numër të konsiderueshëm studentësh që punojnë ose që tashmë janë bërë prindër.

Mundëson fitim aftësish teknike e teknologjike dhe zgjerim të aftësive komunikative lidhur me përdorimin e programeve kompjuterike ose aplikacioneve që mundësojnë

komunikimin online, aspekt që kontribuon në formimin e tyre si profesionistë në të ardhmen.

Leksionet ose materialet plotësuese përmes mësimit online mund të regjistrohen, ruhen ose shpërndahen lehtësisht, fakt që i shërben studentëve për t'i pasur këto materiale si pjesë të një biblioteke personale në mënyrë që t'i referohen atyre në të ardhmen.

Përshtatet me shumë stile të të mësuarit dhe i mundëson studentëve të bëhen më kreativë në procesin e mësimnxënies ose kur realizojnë detyra ose punime të tyre.

Mundëson kalimin e një kohe më të gjatë pranë familjes, aspekt që i lehtëson studentët të cilët jetojnë larg tyre lidhur me punët e përditshme si gatimi ose pastrimi dhe i fokuson më tepër në procesin e të mësuarit, faktor ky që i redukton edhe stresin.

Mundëson zhvillim të vetëdisiplinës dhe rregullit personal e gjithashtu zgjeron horizontet lidhur me fitimin e perspektivave në fusha të ndryshme.

Mundësoi siguri shëndetësore dhe vazhdimësinë e procesit mësimor gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.

Perceptimet e studentëve lidhur me disavantazhet e mësimit online:

Pamundësi për qëndrimi përpara ekraneve për një kohë të gjatë si rezultat i shpërqëndrimeve nga rrjetet sociale, shpërqëndrime të tjera brenda shtëpisë, ose nga mungesa e kontrollit nga ana pedagogëve.

Pamundësia për akses në internet, duke qënë se një numër i lartë i tyre jetojnë në fshatra ose në zona të thella, ku është e pamundur ose e vështirë për t'u aksesuar në internet,

interneti është tepër i dobët e me shkëputje të vazhdueshme ose ka shkëputje të shpeshta të energjisë elektrike.

Mungesa e interaktivitetit ballë për ballë lidhur me stafin pedagogjik ose me studentët e tjerë, që ka rritur depresionin, stresin, ndjenjën e izolimit ose mungesën e theksuar të motivimit.

Vështirësi për të siguruar mjetet e nevojshme për të mësuar online, qoftë edhe një pajisje elektronike të thjeshtë ose kryerja e pagesës së kompanisë së internetit, duke qenë se një pjesë e studentëve përballen me vështirësi ekonomike.

Rritja e ngarkesës lidhur me detyrat e dhëna nga pedagogët, faktor që mundëson shtimin e orëve të kaluara përpara ekraneve elektronike.

Probleme fizike lidhur me posturën, qëndrimin ulur për një periudhë të gjatë kohore dhe dëmtimin e shikimit.

Fokusi vihet më tepër në teori sesa në praktikë, aspekt që ul efektivitetin e mësimdhënies.

Limitimi i feedback-ut të studentëve gjatë orëve mësimore.

Perceptimet e studentëve lidhur me mënyrat e përmirësimit të mësimin online:

Ofrimi i kushteve minimale për studentët që janë të pamundur për të marrë pjesë aktivisht në mësimin online, duke iu siguruar të paktën akses në internet ose pajisje të thjeshta elektronike.

Të rritet korrektësia lidhur me respektimin e orareve nga ana e stafit pedagogjik dhe të koncentrohen më tepër detyrat që u jepen studentëve.

Të përdoren aplikacione ose platforma më efektive dhe më të lehta në përdorimin për t'i dhënë të gjithëve mundësi aksesimi.

Të organizohen më mirë orët mësimore, të shtohen elementë audio-vizivë gjatë leksioneve për të rritur përqëndrimin dhe larmishmërinë, të bëhen pushime të shkurtra gjatë orëve të gjata të mësimin.

Përfundime dhe Rekomandime

Viti akademik 2020-2021 në universitetet shqiptare u realizua më së shumti online, përmes platformave ose aplikacioneve nga më të ndryshmet. Ja përse në këtë punim u përdor një pyetësor, i cili u plotësua nga studentë që studiojnë në universitetet e tre qyteteve të Shqipërisë, për të qenë më pranë perceptimeve, nevojave dhe ideve të tyre lidhur me efektivitetin, avantazhet, disavantazhet, motivimin dhe mënyrat e përmirësimit të realizimit të mësimin online. Nga analizimi i të dhënave të punimit dhe rezultatet e tij u vu re se shumca studentëve pjesëmarrës nuk e shohin mësimdhënien online si efektive dhe përshkohen nga një motivacion i ulët gjatë ndjekjes së saj. Ndonëse kjo mënyrë e zhvillimit të mësimin paraqet avantazhe dhe iu gjend pranë studentëve edhe gjatë pandemisë COVID-19 duke mundësuar siguri shëndetësore dhe vazhdimësi të vitit shkollor, nuk mund të lihen pa përmendur edhe disavantazhet dhe hapësirat për përmirësim që kërkojnë kohë dhe investim në shumë dimensione, në mënyrë që procesi mësimor i zhvilluar online të jetë më pranë studentëve dhe të funksionojë në mënyrë më efektive.

Si rrjedhojë, rekomandojmë që:

T'u mundësohet të gjithë studentëve akses i barabartë në teknologji, që do të thotë se instancat shtetërore duhet të sigurojnë të drejtën për arsim për të gjithë edhe në kushtet e kësaj emergjence didaktike të shkaktuar nga pandemia Covid-19.

T'u ofrohen studentëve platforma online që t'i përafrohen sa më shumë realitetit të të mësuarit në klasë, duke shtuar edhe elementë audio-vizivë gjatë leksioneve për të rritur përqëndrimin dhe larmishmërinë.

Të trajnohen lektorët për t'u pasuruar me sa më shumë dije mbi teknikat moderne të mësimit online, me qëllim shmangien e ndjenjës së apatisë gjatë leksioneve nga ana e studentëve. Kësisoj, studentët nuk do të ishin thjesht dëgjues pasivë në anën tjetër të kompjuterit, por pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimit.

Fokusi të vendoset jo aq te dhënia e leksioneve teorike, por te adaptimi i tyre edhe në praktikë. Për këtë nevojiten teknika që rritin pjesëmarrjen në debatin në klasën online.

Studentëve t'u lihet më tepër kohë për prezantime të ndryshme detyrash, projektsh, cka avantazhon pjesëmarrjen aktive në klasën online.

Bibliografia

Tallent-Runnels, M. K. Thomas, J. A. Lan, W. Y. Cooper, S. Ahern, T. C. Shaw, Sh. M. Liu, X (2006). Teaching Courses Online: A Review of the Research. American Educational Research Association, 76, 1, 93. Retrieved May 11, 2021 from [Teaching Courses Online: A Review of the Research \(jstor.org\)](https://www.jstor.org/stable/4149141)

Isman, A. Gazi, Z. Altmay, F. (2010). Students' Perceptions of Online Learning. Educational Technology Publications, 50, 3, 54. Retrieved May 10, 2021 from [Students' Perceptions of Online Learning \(jstor.org\)](#)

Park, S. Y. (2009). An Analysis of the Technology Acceptance Model in Understanding University Students' Behavioral Intention to Use e-Learning. International Forum of Educational Technology & Society, 12, 3, 150. Retrieved May 7, 2021 from [An Analysis of the Technology Acceptance Model in Understanding University Students' Behavioral Intention to Use e-Learning \(jstor.org\)](#)

Hung, Ch. Hwang, G. Huang, I. (2012). A Project-based Digital Storytelling Approach for Improving Students' Learning Motivation, Problem-Solving Competence and Learning Achievement. International Forum of Educational Technology & Society, 15, 4, 368-369. Retrieved May 25, 2021 from [A Project-based Digital Storytelling Approach for Improving Students' Learning Motivation, Problem-Solving Competence and Learning Achievement \(jstor.org\)](#)

Bali, S. Liu, M. C. (2018). Students' perceptions toward online learning and face-to-face learning courses. Journal of Physics, 1108, 1-2. Retrieved May 15, 2021 from [pdf \(iop.org\)](#)

Woytus, A. (2020). Does Virtual Learning Work for Every Student? JSTOR Daily, 2-3. Retrieved May 5, 2021 from [Does Virtual Learning Work for Every Student? | JSTOR Daily](#)